



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
INSPEKTORATI QENDROR
SEKTORI JURIDIK

Nr. 248 Prot.

Tiranë, më 28/03 2019

Lënda: Dhënie mendimi për projektvendimin, për miratimin e rregullit teknik, "Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së instalimeve elektrike të tensionit të lartë mbi 1kV".

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit", Tiranë

Në përgjigje Tuajës nr. 2710 Prot., datë 04.03.2019, ku kërkohet dhënie mendimi për projektvendimin, për miratimin e rregullave "Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së instalimeve elektrike të tensionit të lartë mbi 1kV", Inspektorati Qendror shpreh dakordësinë në tërësi, por sygjeron sa vijon:

Në veprimtarinë e tyre inspektuese Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, inspektojnë zbatimin e disa dispozitave ligjore që rrjedhin nga ligji 10489, datë 15.12.2011, "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", i ndryshuar. Për këtë arsye Inspektorati Qendror, sygjeron që të përcaktohet qartë struktura përgjegjëse e inspektoratit shtetëror në këtë rregullore, (emërtesa e inspektoratit përgjegjës), pasi aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e pajisjeve elektrike janë objekt i inspektimit nga dy inspektorate shtetërore, ai i ISHMT dhe ISHTI, të cilat janë në varësi të ministrive të ndryshme sipas përgjegjëse së tyre të linjës.

Gjithashtu, propozojmë që në nenin 9, "Aksidentet", në fund të paragrafit ku thuhet se:..., "një kopje të këtij raporti duhet ta paraqesë pranë Inspektoratit shtetëror përgjegjës për energjinë elektrike, të shtohet edhe Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore", si inspektorat përgjegjës për verifikimin e zbatimit të ligjit nr.10 237, datë 18.2.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", të ndryshuar, i cili zbatohet në të gjithë sektorët e veprimtarisë private dhe publike, për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksidente në punë, si një detyrim i punëdhënësit për të njoftuar për ngjarjen.

Në aneksin 20, pika 2.2, "Inspektimi", paragrafi të bëhet: "Inspektorati shtetëror përgjegjës të kryejë inspektime sipas ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

SHKËLQIM HAJDARI